

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura III

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion  
Mbledhja nr. 29/2009

Më 08. 12. 2009, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

### **Procesverbal**

**Në mbledhje morën pjesë:** Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Sala Berisha-Shala, Nerxhivane Dauti, Zef Morina, Fatmir Rexhepi, Qamile Morina dhe Myfera Sinik.

**Munguan:** Slobodan Petroviq, Fatmir Rexhepi dhe Kaqusha Jashari.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Fadil Mustafaj, Bujar Kuçi – MTI, Adi Kamerolli, Nazmi Rrahmani – MTPT, Besim Zeqiri – ICO, Ramadan Klisurica – KDI, Lumnije Murati - ZPRK, Ismet Mahmuti - Zyra për Informim dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent i Komisionit.

**Nga Zyra Mbështetëse:** Hasan Tahiri, Advije Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

### **Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës ( 01.12. 2009);
3. Shqyrtimi i Projektligjit për turizëm dhe shërbime turistike;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbime postare;
5. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 01.12. 2009**

*Procesverbali i mbledhjes së datës 01.12.. 2009 u miratua me vërejtje.*

**Myzejene Selmani**, kryetare – E njoftoi Komisionin për vërejtjet që iu kanë bërë Komisionit nga kryetari i Kuvendit, në takimin me kryetarë të komisioneve për mos shqyrtimin-amendamentimin e projektligjeve, të cilat kanë kaluar në lexim të parë. Jemi të detyruar ta shpejtojmë punën e grupeve të punës. Të organizohen takime pune, si dhe të përgatiten raporte me amendamente për procedim të mëtejshëm.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit për turizëm dhe shërbime turistike.**

**Kryetarja Selmani** – E prezantoi Raportin e grupit të punës në krye me Qamile Morinën - raportuese.

**Nerxhivane Dauti** - Vlerësoi se shumica prej këtyre propozimeve janë të arsyeshme dhe të qëndrueshme. Me këto amendamente P/ligji do jetë në një shkallë shumë më të lartë të standardizimit juridik e gjuhësor. Ka edhe amendamente që janë edhe përmbajtjesore, të cilat do të vlerësohen nga anëtarët e Komisionit.

**Myzejne Selmani** - Kishte vërejtje në parim për sponsoruesin - MTI, ngase në shumicën e P/ligjeve po propozon agjenci, këshilla dhe komisione, të cilat në të shumtën e rasteve janë ngarkesë buxhetore. Edhe me këtë P/ligj është propozuar një këshill kosovar për turizëm (neni 23), që, sipas saj, është i panevojshëm. Sipas saj të gjitha funksionet e tij mund t'i realizojë Departamenti për Turizëm, i cili edhe ekziston në kuadër të MTI - së.

**Ethem Çeku** - Vlerësoi se P/ligji në përmbajtje ka shumë përshkrime e hollësi formale, të cilat sipas tij, duhet kërkuar thjeshtësime e në shumë raste edhe mundësi të rregullimit të hollësive edhe me akte nënligjore. Në parim ai ishte për një përkushtim më serioz në çështjet ku ka implikime buxhetore.

**Nerxhivane Dauti**- Propozoi që të trajtohet çdo nen i P/ligjit dhe paralelisht me nenet të prezantohen propozimet – vërejtjet e anëtarëve, si dhe në të njëjtën kohë të prezantohet edhe amendamenti i grupit të punës.

Në vazhdim Nerxhivane Dauti me Qamile Morinën vazhduan prezantimin e vërejtjeve dhe të propozimeve sipas marrëveshjes, nen për nen të P/ligjit dhe të propozimeve të amendamenteve.

Komisioni u pajtua që lidhur me nenet 1; neni 3 (dhjetë përkufizime riformulohen, ndryshohen e plotësohen); neni 4.1; 4.2.3; 9.3; 10.2; 12.1.2; 16; 19.2; 19.4; 19.5; 21;

22.1; 22.1.2; 23; 24; 26.1; 27; 28; 29; 31; 32; 33.1.1; 34.1.2; 35.6; 37.1; 37.3; 37.1.7; 40.1.1; 40.1.2; 40.1.3; 40.3; 43.1.2; dhe neni 44 të miratohen amendamente.

Meqenëse, lidhur me një nen mund të ketë disa propozim-ndryshime ose amendamente, Komisioni u pajtua që në raste të tilla të hartohet vetëm një amendament. Ky qëndrim është në frymën e efikasitetit dhe të ekonomizimit të kohës gjatë miratimit në cilëndo instancë.

Debati më i theksuar: grupit raportues i propozoi që neni 6 i P/ligjit, që ua mundëson shoqërive kulturo - artistike, shoqatave të pensionistëve, fetare e të tjera, të organizojnë paketë - aranzhmane turistike për anëtarët e vet, të hiqet, me arsyetim se vetëm agjencitë e organizuara dhe të legalizuara duhet të organizojnë aranzhmane turistike.

Komisioni nuk u pajtua të hiqet ky nen (6), ngase shoqatave duhet t'u mundësohet organizimi i vizitave turistike në formën e organizimit, të cilën ato e përcaktojnë, por gjithsesi aktivitetet turistike nënkuptohet se i realizojnë përmes agjencive turistike të regjistruara.

Komisioni debatoi edhe lidhur me heqjen e nenit 11, ngase kishte paraparë shumë detyra të përshkruara në hollësi, për të cilat ishte vlerësimi se këto çështje duhet rregulluar me akt nënligjor.

Në fund Komisioni u pajtua që kjo normë të mbetet ashtu, si është në P/ligj, nga fakti se ky nen dhe paragrafët e tij janë referencë e shumë dispozitave ndëshkimore dhe në aspektin e rregullimit teknik krijon vështirësi, si dhe shumë dispozita ndëshkimore mbeten pa lëndë, të cilat pastaj do të duhej të hiqeshin.

Lidhur me neni 23 ( themelimi i këshillit kosovar për turizëm) është zhvilluar debat nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

Zef Morina, Sala Berisha - Shala, Ethem Çeku dhe Qamile Morina ishin të mendimit dhe kërkuan sqarime, sepse ky nen ka implikime buxhetore apo jo? Dhe pas analizave doli përfundimi se ka implikime buxhetore.

Pas debatit pasoi vlerësimi i përgjithshëm se ky nen duhet të hiqet, ngase është i pa nevojshëm për rrethanat e përgjithshme ekonomike, e në veçanti të shkallës së zhvillimit të turizmit. U vlerësua se ky nen do ketë implikime buxhetore, pra do *jetë më tepër ngarkesë buxhetore. U vlerësua se të gjitha funksionet e këtij këshilli do t'i kryej me sukses departamenti ekzistues për turizëm në kuadër të MT I- së.*

*Në fund Komisioni votoi me rezultat unanimit për heqje të këtij neni (23).*

Debati vazhdoi për nenin 24, **që e përcakton** ministrin autoritet për lëshimin e certifikatave për ciceron, animator dhe shoqërues turistik.

Qamile Morina propozoi që certifikatën në kuptimin profesional duhet ta lëshojë institucioni arsimor, kurse lejen për punë ministria.

Komisioni u pajtua pas një debati, në të cilin u kyçën të gjithë dhe u miratua ky propozim. U hartua edhe amendament me të cilin Ministria lëshon leje të punës sipas kritereve që i përcakton me akt nënligjor, kurse certifikatën duhet lëshuar vetëm institucionet e arsimit përkatës.

Debat u zhvillua për nenet 26, 27, 28, dhe 29. Me këto nene janë paraparë llojet e turizmit. Komisioni vlerësoi se këto nene nuk janë norma, por përkufizime të cilat ose duhet shndërruar në norma, ose duhet sistemuar në përkufizime.

U vlerësua se transferimi në përkufizime nuk ka vlerë, ngase pjesa normative mbetet pa objekt, andaj u vendos që këto nene të shndërrohen në norma duke i riformuluar.

Debati u zhvillua edhe për nenin 31, i cili përcakton përmbajtjen e ligjit. Komisioni vlerësoi se ky nen duhet të hiqet, ngase qëllimi dhe përmbajtja, si dhe fusha e zbatimit janë trajtuar në nenet 1 dhe 2 të ligjit, andaj u pajtuan të hiqet.

**Bujar Kuçi**, drejtor i Departamentit për Turizëm në MTI - Gjatë shqyrtimit të P/ligjit, në të gjitha nenet për të cilat u zhvillua debati dha sqarime dhe, për shumicën e tyre, u pajtua përveç nenit 23, që sipas tij, këshilli duhet themeluar.

Komisioni i votoi të gjitha amendamentet veç e veç dhe në fund të gjitha në tërësi me votë unanime.

Gjithsejtë u votuan 27 amendamente.

Komisioni autorizoi njësinë mbështetëse, që në aspektin e standardizimit juridik - teknik dhe gjuhësor ta përgatisë raportin dhe ta procedojë në pajtim me rregullat e Rregullores së punës të Kuvendit.

### **Përfundim**

Miratohet amendamenti i P/ligjit për shërbime turistike dhe turizëm, me 27 amendamente.

### **V Të ndryshme**

Me kërkesë të kryetares Selmani, grupi i punës gjatë javës takohet dhe e shqyrton P/ligjin për miniera dhe minerale me kërkesë që sa ma parë, gjegjësisht brenda vitit, të përfundohet me amendamentim të tij.

**Mbledhja përfundoi në orën 13: 00**

**Kryetare e Komisionit**

---

**Myzejene Selmani**